

Terma Reference

Thirrje për ekspert për vlerësimin e infrastrukturës së institucioneve të Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç Korçë dhe Vlorë

Konsulenca	Ekspert për vlerësimin e infrastrukturës së institucioneve të Shtëpive të Fëmijës 0-5 vjeç Korçë dhe Vlorë
Projekti	“Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF (ALB/PCA202213/PD202359)
Kohëzgjatja e shërbimit	Maj-Qershor 2023
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	25 Maj 2023

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë **ekspert për realizimin e vlerësimit të infrastrukturës së institucioneve të Shtëpisë së Fëmijës „Lulet e Vogla“ 0-5 vjeç në Korçë dhe Shtëpisë së Fëmijës Vlorë**, në kuadër të projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF dhe financuar nga Qeveria Suedeze. Kjo ekspertizë do të ofrohet në mbështetje të grupit të punës të ngritur pranë MSHMS për vlerësimin e infrastrukturës së institucionit të përkujdesit shoqëror „Shtëpia e Foshnjës“ Vlorë dhe Shtëpia e Foshnjës „Lulet e Vogla“ Korçë në kuadër të planit të transformimit për institucionet e përkujdesit shoqëror në Shqipëri- Pilot Bashkia Korçë dhe Vlorë.

Të dy Institucionet e përkujdesit shoqëror (IPSH) për grup-moshën e fëmijëve 0-5 vjeç në Bashkitë Korçë dhe Vlorë, të cilat në bazë të VKM nr.706, dt.09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit (PKD), 2020-2022, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”, Objektivi 2 strategjik, janë 2 institucionet e para të vendosura në moratorium dhe në fazë pilotimi të transformimit të shërbimeve.

Për secilin nga Institucionet po zhvillohet një plan i detajuar transformimi, i cili përfshin vlerësimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre, burimet njerëzore ekzistuese, dhe të infrastrukturës së institucionit të përkujdesit shoqëror.

Informacion i Përgjithshëm:

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrim i projektit:

Projekti ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë mbështetje për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të ofrojë shërbime mbështetëse të integruara për fëmijët dhe familjet në nevojë dhe në nivel të lartë vulnerabiliteti nga abuzimi, shfrytëzimi dhe trafikimi. Projekti fokusohet jo vetëm në mbështetje për fuqizimin e familjeve dhe fëmijëve, por edhe pilotimin e shërbimeve të reja mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjet kujdestare profesionale si dhe ngritja e kapaciteteve për punonjësit që janë pjesë e ofrimit të shërbimeve dhe kujdesit social në kuadër të avancimit të procesit të deinstitutionalizimit.

Grupet përfituese dhe aktorët kyç:

- Prindër/ kujdestarë të identifikuar në nevojë për mbrojtje ose në nevojë për referim në shërbimet e kujdesit social;
- Fëmijë të vlerësuar në risk të mesëm ose të lartë ndaj shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit;
- Fëmijë të vendosur në shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial;
- Familje me fëmijë në risk për tu institucionalizuar;
- Punonjës të strukturave vendore, përgjegjës për mirëqenien e fëmijëve;
- Punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Detyrat dhe përgjegjësitë për ekspertin:

Eksperti inxhinier/arkitekt ka si detyrë të mbështesë grupin e punës të ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në Bashkitë Korçë dhe Vlorë për të vlerësuar dy godinat e Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç në Korçë dhe Vlorë nga ana infrastrukturore. Për të realizuar detyrën e tij, eksperti duhet të njihet prapakisht me Planin e Transformimit të Instiucioneve të përkujdesit.

Grupi i punës përbëhet nga :

- Përfaqësues nga MSHMS,
- Përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror,
- Përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetror (Korçë dhe Vlorë),
- Përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike së Burimeve Njerëzore në Bashkitë Korçë/Vlorë,
- Përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Korçë/Vlorë,
- Ekspert inxhinier/arkitekt për hartimin e metodologjisë së grupit të punës dhe vlerësimit të infrastrukturës.

Secili anëtar i grupit do të ushtrorë funksionet e tij në punën në grup në përputhje me kompetencat institucionale.

Eksperti do të realizojë ekspertizën e tij duke:

- Hartuar metodologjinë e punës për realizimin e vlerësimit;
- Hartimin e kalendarit të punës për kryerjen e procesit të vlerësimit;
- Realizimin e procesit të vlerësimit të infrastrukturës:
 - a) Kryerjen e vlerësimit të infrastrukturës që lidhet me specifikat si: vlerësimi i vlerës së godinave, vlerësimi i kushteve të jetesës së banorëve, kapaciteti strehues, të strukturës mbajtëse, sistemi hidraulik, elektrik, termik, vlerësimi i nivelit të sigurisë së një godine, etj.

- b) Analiza e dokumentacionit - Dokumentacioni mund të përfshijë plane të ndërtimit, planifikim urbanistik, leje ndërtimi, certifikata sigurie, etj. Kjo analizë mund të ndihmojë në vlerësimin e saktë të godinës dhe mund të zbulojë çdo mungesë në dokumentacioni.
 - c) Inspektimi fizik – matje në terren të çdo hapësire të godinës, si dhe kontrollin e sistemeve të sigurimit, pajisjeve dhe paisjeve. Në këtë mënyrë, mund të identifikohen mungesat dhe dëmtimet në godinë.
 - d) Vlerësimi i godinës mund të përfshijë krahasimin e saj me standarde dhe rregullore të vendosura nga organet përgjegjëse. Kjo mund të përfshijë standarde për sigurinë, shëndetin publik, etj.
 - e) Të identifikojë ndërhyrjet e nevojshme për rehabilitimin e secilës godinë dhe kostot përkatëse duke u orientuar nga udhëzimet e grupit të punës që mjediset të ripërshtaten për ofrimin e shërbimeve sipas planit të transformimit.
- Hartimin e raportit të vlerësimit që përmban të dhëna të detajuara dhe një vlerësim përfundimtar të gjendjes së godinës.

Për hartimin e metodologjisë, eksperti do të jetë në komunikim me anëtarët e grupit përfaqësues të MSHMS, SHSSH, Bashki, IPSH me qëllim konsultimin dhe reflektimin e komenteve të grupit që do të kryejë vlerësimin në terren.

Profili i ekspertit:

I. Kualifikime

- Diplomë universitare/pasuniversitare në shkenca inxhinierike (arkitekt, inxhinier ndërtimi, etj);
- Të ketë eksperiencë pune në vlerësimin e pasurive të paluajtshme.
- Të jetë i/e pajisur me licencë.

II. Eksperienca e punës

- Të ketë jo më pak se 10 vite eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj.
- Të zotërojë aftësi të avancuara analitike për të vlerësuar kushtet e një godine dhe për të identifikuar problemet potenciale që lidhen me ofrimin e shërbimeve;
- Të zotërojë aftësi të mira komunikuese për të ndërtuar marrëdhënie të mira dhe të menaxhojë situatat me anëtarët e grupit të punës, stafin në terren dhe të shpjegojë vlerësimet e tij në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
- Të zotërojë njohuri shumë të mira teknike të sistemeve të ndërtimeve, përfshirë sisteme të energjisë, sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimeve, sistemeve të ajrit dhe sisteme të tjera dhe roli i tyre në ofrimin e shërbimeve.
- Të ketë aftësi për të punuar në ekip me secilin anëtar të grupit të punës dhe të bashkëpunojë me të tjerët për të arritur objektivat e përbashkëta.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze në formën e shkruar dhe të folur;
- Mundësi dhe dëshirë për të lëvizur në terren;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes të NISMA ARSIS.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 25 maj 2023

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës maj-qershor 2023

Kjo ekspertizë përfshin 8 ditë pune.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për secilin nga pozicionet e sipër shënuara duhet të dërgojnë me email

- 1- CV-në;
- 2- Letër interesi;
- 3- Letër angazhimi/disponueshmërie;
- 4- Ofertën financiare;
- 5- Taksa e regjistrimit (nëse disponohet).

në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **23 Maj 2023**, mesnatë.

Në vëmendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për pozicionin e ekspertit për realizimin e vlerësimit të infrastrukturës së godinave në IPSH-të Korçë dhe Vlorë.

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e ekspertit do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.